



UNIVERSITETI I TETOVËS  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО  
UNIVERSITY OF TETOVO

## FLETËPARAQITJE E TEZËS SË MAGJISTRATURËS

- Emri dhe mbiemri i studentit:
- Fakulteti:
- Programi studimor:
- Drejtimi:
- Numri i dosjes:
- Viti akademik i regjistrimit të studimeve:
- Disiplina shkencore e temës:

**TEMA:**

“ \_\_\_\_\_ ”

Tetovë, \_\_\_/\_\_\_/201\_\_

## **1. LËNDA E HULUMTIMIT**

### **1.1 ARSYETIMI I TEMËS**

(Këtu shkurtimisht përmendet rëndësia e temës, duke e arsyetuar të njëjtën për realizimin e saj, nevojën shkencore për t'u realizuar etj.)

### **1.2 QASJA TEORIKE DHE DEFINIMI I PROBLEMIT TË HULUMTIMIT**

(Të përmendet aspekti teorik i lëndës së hulumtimit, hulumtime të ngjashme dhe qartë, saktë të definohet problemi kryesor i këtij hulumtimi)

## **2. KORNIZA METODOLOGJIKE**

### **2.1 QËLLIMET DHE DETYRAT E HULUMTIMIT**

Të parashtrohen qëllimet që hulumtuesi dëshiron të arrijë me këtë punim;

### **2.2 HIPOTEZAT E HULUMTIMIT**

Hipotezat duhet t'i plotësojnë kriteret e nevojshme për formulimin e hipotezave, duhet të jenë logjike, të mund të testohen, të përmbajnë relacione të qarta mes variablave të hulumtimit etj.

### **2.3 DEFINIMI I VARIABLAVE**

Këtu definohen dhe operacionalizohen saktë variablat kryesore të hulumtimit, subshkallët e tyre, shndërrimi i tyre në njësi matëse etj.

### **2.4 METODAT SHKENCORE TË HULUMTIMIT**

Të përshkruhet dhe arsyetohet metoda shkencore përmes së cilës do të arrihet deri te realizimi i këtij projekti;

### **2.5 TEKNIKAT OSE INSTRUMENTET MATËSE**

Të potencohet, përshkruhet dhe arsyetohet teknika apo instrumenti matës që do të përdoret për matjen e variablave të hulumtimit. Për testet të cilat janë përdorur në ndonjë hulumtim nga dikush tjetër, besueshmëria e arritur, pyetjet që matin variablat, kushtet për t'u realizuar matja e saktë etj.

### **2.6 POPULLACIONI DHE MOSTRA**

Të përshkruhen karakteristikat demografike të mostrës, arsyetimi i përzgjedhjes së mostrës, metodat përmes të cilave është përzgjedhur mostra për të marrë pjesë në hulumtim, numri i subjekteve etj.

### **2.7 METODAT STATISTIKORE PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE**

Të përmenden metodat statistikore përmes të cilave do të bëhet përpunimi i të dhënave. Të njëjtat duhet të potencohen se për verifikimin e

cilës hipotezë janë të nevojshme, respektivisht të arsyetohet nevoja e aplikimit të një statistike të caktuar.

## **2.8 INTERPRETIMI I REZULTATEVE NGA HULUMTIMI**

Duhet të theksohet se si do të bëhet interpretimi i rezultateve të arritura e të konstatuara.

## **2.9 ORGANIZIMI DHE ECURIA E HULUMTIMIT**

Në këtë fazë duhet të përmendet saktë i gjithë plani për realizimin empirik të hulumtimit. Duke filluar nga koha e realizimit, vendi, kushtet, aplikimi në mostër, kushtet dhe kriteret e realizimit etj. Të përshkruhet e gjithë ecuria e nevojshme duke u arsyetuar. Mjetet e nevojshme etj.

## **3. PËRFUNDIMI**

Të theksohen arritjet profesionale apo shkencore të cilat priten, zbatimi i rezultateve nga kërkimi etj.

## **4. BIBLIOGRAFIA**

Të pasqyrohet lista e literaturës dhe burimeve tjera.

- Fletëparaqitja e tezës së magjistraturës është një projekt ideor apo propozim temë, në të cilën duhet saktë të theksohet problemi i hulumtimit, të përshkruhen saktë të gjitha fazat në të cilat do të realizohet i gjithë punimi;
- Propozim tema, duhet të jenë një plan konkret i gjithë punës e cila do të realizohet më tutje;
- Projekti ideor duhet të përmbajë kontiunitet të variablave të zgjedhura për t'u analizuar, prej te titulli i temës duke vazhduar me të gjitha fazat tjera të përcaktuara;
- Të theksohet dhe arsyetohet saktë përdorimi i metodës shkencore të zgjedhur për hulumtimin;
- Të respektohen plotësisht të gjitha kriteret e caktuara metodologjike shkencore e të gjitha fazave të projektit, i cili do të realizohet;
- Bibliografia e nevojshme për realizimin e projektit të theksohet në përputhje me standardet e përcaktuara metodologjike, varësisht natyrës së burimit;
- Propozim teza nuk duhet të jetë më shumë se 15 faqe A4.